



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

V E N D I M

Nr. 4, Datë 20.06.2018

PËR

**MIRATIMIN E NISMËS PËR HARTIMIN E PLANIT TË DETAJUAR PËR ZONËN
E RËNDËSISË KOMBËTARE MES LAGUNËS SË KARAVASTASË DHE LUMIT
SEMAN**

Në mbështetje të neneve 7, 8, 9, 10, 18 dhe 25 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me kërkesë të Komitetit të Investimeve Strategjike nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Nismës për hartimin e Planit të Detajuar për Zonën e Rëndësisë Kombëtare mes Lagunës së Karavastasë dhe Lumit Seman.
2. Dokumenti i plotë i Nismës për hartimin e Planit të Detajuar për Zonën e Rëndësisë Kombëtare mes Lagunës së Karavastasë dhe Lumit Seman përmban:
 - a) kufijtë territorialë të PDZRK-së;
 - b) qëllimin dhe nevojën për hartimin e PDZRK-së;
 - c) bazën ligjore për hartimin e PDZRK-së;
 - ç) fazën/fazat e hartimit të PDZRK-së;
 - d) dokumentet përbërëse të PDZRK-së;
 - dh) ekspertët (fushat e ekspertizës) që do të përbëjnë grupin e punës që do të hartojnë PDZRK-në;
 - e) planin e veprimeve për hartimin, bashkërendimin dhe këshillimin e dokumenteve të PDZRK-së;
 - f) buxhetin për hartimin e PDZRK-së.

3. Ngritjen e grupit të punës me ekspertë nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve dhe Bashkia Divjakë, me qëllim hartimin e Planit të Detajuar për Zonën e Rëndësisë Kombëtare mes Lagunës së Karavastasë dhe Lumit Seman.
4. Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit të drejtojë punën për formimin e grupit të punës, hartimin e PDZRK-së dhe bashkërendimin e këshillimin me të gjitha autoritetet e planifikimit dhe palët e interesuara.
5. Plani i Detajuar për Zonën e Rëndësisë Kombëtare mes Lagunës së Karavastasë dhe Lumit Seman duhet të hartohet bazuar në Vendimet e Komitetit të Investimeve Strategjike dhe Vendimeve të Këshillit të Ministrave në vijim të tyre, si dhe bazuar në udhëzimet e dokumentit të Nismës për hartimin e tij.
6. Pjesë përbërese e këtij Vendimi është dokumentacioni i plotë përbërës i Nismës për Hartimin e Planit të Detajuar për Zonën e Rëndësisë Kombëtare mes Lagunës së Karavastasë dhe Lumit Seman.
7. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve dhe Bashkia Divjakë për zbatimin e këtij Vendimi.
8. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA

